

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Shërbimi i kërkesës për informacion publik nëpërmjet e-Albania

Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Për të mundësuar trajtimin e kërkesave për informacion dhe ankesave nëpërmjet portalit e-Albania, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI-n, mundësoi trajnimin e koordinatorëve të Autoriteteve Publike si dhe konfigurimin në sistemin AMS të kredencialeve të koordinatorëve në adresat e-mail të tyre.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi u publikuan në portalin e-Albania shërbimet “Kërkesë për informacion publik” dhe “Ankesa për refuzim dhënie informacioni publik”. Deri tani ky shërbim është funksional për 40 Autoritete Publike, ndërkohë që procesi është në vazhdim në autoritetet e tjera.

Qytetarët që logohen në sistemin e-Albania tashmë mund të aksesojnë shërbimin e kërkesës për informacion publik dhe shërbimin e ankesës për refuzim dhënie informacioni publik drejtëpërdrejtë në portal.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim nr. 48 - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Vendim Nr. 49 - Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Vendim Nr. 50 - Banka e Shqipërisë

Vendim Nr. 51 - Bashkia Krujë

Vendim Nr. 52 - Ministria e Drejtësisë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2021, ka dhënë 5 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Me anë të vendimit nr. 50, datë 17.11.2021, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Bankës së Shqipërisë" (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ku kërkohej informacion mbi:

Emrat dhe pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe pagën mujore.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI). Pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, Autoriteti Publik në përgjigjen e tij argumentoi se: "...Banka e Shqipërisë administron të dhënat personale të punonjësve të tij, në bazë të dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe dispozitave të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 16.05.2007, i ndryshuar. Këto të dhëna personale përfshijnë informacione të karakterit profesional e administrativ, si dhe informacione të tjera personale për çdo punonjës të institucionit. Çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar apo të identifikueshëm, përbën të dhënë personale në kuptimin që jep neni 3 i ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në rastin konkret duke qenë se të dhënat që kërkohej të identifikojnë personin fizik (punonjës) të cilit i përkasin, ato kategorizohen si të dhëna personale e tij në kuptim të nenit 3 të ligjit, dhe për rrjedhojë bazuar në nenin 27 dhe 28

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

të këtij ligji përdoren vetëm për qëllimin përse janë mbledhur dhe konsiderohen konfidenciale, pra jo publike.

Këtë logjikë ka parasysh edhe neni 7 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili në shkronjën "d" të tij konsiderohen ndër të tjera si të dhëna publike pagat vetëm të funksionarëve të cilët kanë detyrim deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, ndërsa për nëpunësit e tjerë ky ligj nuk kërkon identifikimin me të dhëna personale. Për rrjedhojë, në zbatim të dispozitave të sipërcituara, Banka e Shqipërisë nuk mund të vendosë në dispozicion të dhëna që identifikojnë punonjësit..."

Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstatoi se në parim, e drejta e aksesit në të dhënat personale sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është një e drejtë që gëzohet nga subjekti i të dhënave personale. Në rastin konkret, kërkesa për informacion e paraqitur nga ankuesi bazohet në LDI ku në nenin 17 të tij jepen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit. Një nga kufizimet është edhe ruajtja e jetës private. Por, duke qenë se kërkohej të dhëna që lidhen me ushtrimin e detyrës funksionale të punonjësve në një autoritet publik sipas ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, gjen zbatim shkronja b) e pikës 4 të nenit 4, të Ligjit nr. 9887 i "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në të cilin parashikohet: "Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre".

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezultoi i bazuar në ligj.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Transparencë në veprimtarinë e Prokurorisë

Me temë “Komunikimi efektiv me median dhe publikun, garanci për mirëfunksionimin e institucioneve të drejtësisë” u mbajt trajnimi i organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Misioni PAMECA V (Misioni i asistencës së BE për institucionet shqiptare të zbatimit të ligjit).


Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte e ftuar në këtë aktivitet ku i njohu të pranishmit me legjislacionin e zbatueshëm në këtë fushë dhe me funksionet e autoritetit. Vëmendje iu kushtua përditësimit të Programit të Transparencës, si një instrument i rëndësishëm në informimin e publikut dhe rolit të koordinatorit në procesin e trajtimit të kërkesave të qytetarëve. Gjithashtu, u paraqitën çështje nga praktika në raport me veprimtarinë e prokurorisë apo institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe u diskutua për rastet e kufizimit të të drejtës për informim.

Të pranishëm në këtë trajnim 2-ditor ishin prokurorët e ngarkuar për komunikimin me median nga të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, koordinatorët për të drejtën e informimit të këtij institucioni, si dhe përfaqësues të mediave.




Balanca mes dy të drejtave në veprimtarinë e Autoriteteve Publike të sektorit shëndetësor

Transparencë ndaj publikut duke garantuar respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Ishte kjo tematika e trajnimit të zhvilluar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale të Autoriteteve Publike që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin shëndetësor.



Në aktivitet u trajtuan çështje të zbatimit të kuadrit ligjor në këto fusha në vlerësim të balancuar mes dy të drejtave, si dhe për problematikat e hasura në raport me përballimin e situatës së pandemisë Covid-19. Vëmendje iu kushtua plotësisht dhe përditësimit të rubrikave të Programit të Transparencës për forcimin e transparencës proaktive, duke rritur cilësinë e informacionit për publikun. Gjithashtu, u trajtua ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale shëndetësore, të cilat kategorizohen si sensitive dhe për to garantohen një nivel më i lartë mbrojtjeje. Ndërsa, nëpërmjet rasteve nga praktika, u diskutua edhe për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave (individët), si dhe për rolin e funksionet e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në këtë proces.

Foto nga aktiviteti i Zyrës së Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI-n për ofrimin e shërbimeve “Kërkesë për informacion publik” dhe “Ankesa për refuzim dhënie informacioni publik” në portalin e-Albania



The screenshot shows the website interface for 'Kërkesë për informacion publik' (Public Information Request) on the e-Albania portal. The header includes the e-Albania logo, navigation links for 'KRYESORE', 'E-SHËRBIME', 'SHËRBIME INFORMATIVE', and 'NDIHMË DHE SUPORT', and user options for 'Alketa Koja | Dil' and 'Regjistro një biznes'. A search bar is located at the bottom right of the header.

Kërkesë për informacion publik

Kontaktet
Tel: +35542 237 200
E-mail: info@idp.al
Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Kodë postar 1001, Tiranë
Tiranë

Kërkesë për informacion publik

Kërkesa i drejtohet një autoriteti publik për të marrë informacion publik. Informacion publik, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të Ligjit nr.119/2014, është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kërkesa për informim i drejtohet koordinatorit për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik.

Neni 14 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" parashikon se "Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Dokumentacioni i nevojshëm
Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:
- Dokumente që mbështesin kërkesën e aplikantit.

